

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: Policia e Kosoves

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i prokurimit	214/30400-26-6311-5-5-8
Nr i brendshëm	214-26-069-558

Sa i përket tenderit për: Furnizim me pajisje të teknologjisë informative

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Emri i Kompanisë: **Botek shpk**

Adresa : **rr. Agim Ramadani, nr 517. 10 000 Prishtinë**


Numri Telefonit/ Numri i Faks-it:

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj: **Hilmi Asllani**

Adresa elektronike: hilmi.asllani@bo-tek.com

Data e parashtrimit të ankesës: **21.09.2026**

Nënshkrimi dhe vula:



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë “apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Ftese për tenderim, date 30.07.2026
- Afati i fundit për dorëzim të ofertave, datë: 10.08.2026, ora 14:00
- B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, 01.09.2026
- Kërkesa për Rishqyrtim, datë: 07.09.2026
- Përgjigja nga AK në Kërkesën për Rishqyrtim, datë: 09.09.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Nuk aplikohet

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

- Kërkesa për Rishqyrtim, datë: 07.09.2026
- Përgjigja nga AK në Kërkesën për Rishqyrtim, datë: 09.09.2026

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 i LPP Nr. 04/L-042 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 27 i LPP Nr. 04/L-042 – Dosja e Tenderit
Neni 28 i LPP Nr. 04/L-042 - Specifikimet teknike
Neni 44 i LPP Nr. 04/L-042 - Rregullat e Përgjithshme mbi Caktimin e Afateve Kohore për pranimin e Tenderëve ose Kërkesave për Pjesëmarrje
Neni 53 i LPP Nr. 04/L-042 - Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

PRETENDIM ANKIMOR – LOT 4

Shkelje e dispozitave të LPP-së lidhur me ndryshimin e specifikimit teknik nga minimum 512 GB në minimum 1 TB dhe moszgjatjen e afatit për dorëzimin e ofertave

Ne, **Botek sh.p.k., Prishtinë**, në cilësinë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, paraqesim këtë Ankesë lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat e lartëshënuara, **LOT 4**, pasi konsiderojmë se gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, të ndryshuar dhe plotësuar.

Në dokumentacionin fillestar të tenderit, për **LOT 4**, ishte përcaktuar kërkesa teknike për kapacitetin e diskut prej **minimum 512 GB**. Më pas, kjo kërkesë është ndryshuar nga Autoriteti Kontraktues në **minimum 1 TB**, ndryshim i cili, sipas informatave të publikuara në procedurë, është bërë më datë **07.08.2026**, vetëm disa ditë para skadimit të afatit për dorëzimin e ofertave, dhe atë me kërkesë të një Operatori Ekonomik.

Konsiderojmë se ndryshimi nga **512 GB në 1 TB** nuk përbën një sqarim të thjeshtë apo teknik të karakterit formal, por paraqet **ndryshim substancial të një kërkesë teknike të detyrueshme**, i cili ndikon drejtpërdrejt në përgatitjen dhe përmbajtjen e ofertës së Operatorëve Ekonomikë.

Ky ndryshim ka ndikuar në përzgjedhjen e produktit/modelit konkret, konfigurimin teknik, çmimin e ofertës, sigurimin e ofertave nga prodhuesit dhe/ose distributorët, si dhe në mundësinë e Operatorëve Ekonomikë për të dorëzuar ofertë në përputhje me kërkesën e re teknike.

1. Shkelja e nenit 27 të LPP-së

Sipas **nenit 27 të LPP-së**, Dosja e Tenderit duhet të përmbajë të gjitha informatat relevante dhe kushtet materiale të procedurës, përfshirë specifikimet teknike të aplikueshme.

Në veçanti, **neni 27, paragrafi 4**, përcakton se:

“Kërkesat e përcaktuara në Dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të jenë identike.”

Në rastin konkret, konsiderojmë se ndryshimi i specifikimit teknik nga **512 GB në 1 TB** ka ndryshuar një nga kërkesat materiale të tenderit dhe, për rrjedhojë, nuk mund të trajtohet si një çështje pa ndikim në konkurrencën dhe përgatitjen e ofertave.

Nëse Autoriteti Kontraktues ka konsideruar të nevojshme ndryshimin e kësaj kërkesë, ky ndryshim është dashur të bëhet dhe të komunikohet në mënyrë të tillë që të gjithë Operatorët Ekonomikë të kenë mundësi reale dhe të barabartë për të përshtatur ofertat e tyre me kërkesën e re.

2. Shkelja e nenit 28 të LPP-së

Në pajtim me **nenin 28 të LPP-së**, Autoriteti Kontraktues është i obliguar që specifikimet teknike t'i përcaktojë në Dosjen e Tenderit dhe ato duhet të hartohen në mënyrë që t'u sigurohet të gjithë Operatorëve Ekonomikë të interesuar qasje sa më e mirë në procedurë.

Gjithashtu, sipas këtij neni, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që favorizon ose diskriminon një apo më shumë Operatorë Ekonomikë.

Ne konsiderojmë se ndryshimi i një kërkesë teknike materiale vetëm disa ditë para përfundimit të afatit, pa i dhënë Operatorëve Ekonomikë kohë të mjaftueshme për përshtatjen e ofertave, cenon qëllimin e këtyre dispozitave.

Një Operator Ekonomik që ka përgatitur ofertën mbi bazën e kërkesës fillestare prej **512 GB** nuk mund të supozohet se ka pasur kohë dhe mundësi të njëjtë me një Operator që e ka përgatitur ofertën duke pasur parasysh kërkesën e re prej **1 TB**.

3. Shkelja e nenit 44 të LPP-së – afati i pamjaftueshëm

Sipas **nenit 44 të LPP-së**, afati për pranimin e ofertave duhet të jetë i mjaftueshëm për t'u mundësuar Operatorëve Ekonomikë përgatitjen dhe dorëzimin e ofertave në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktues, duke marrë parasysh natyrën, kompleksitetin dhe vështirësinë e përgatitjes së ofertës.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues ka ndryshuar një kërkesë teknike materiale nga **512 GB në 1 TB** më datë **07.08.2026 (e premte)**, kurse afati për dorëzim të ofertave ka qenë **10.08.2026** pra në një fazë shumë të vonshme të procedurës.

Për këtë arsye, konsiderojmë se afati i mbetur pas këtij ndryshimi nuk ka qenë i mjaftueshëm për t'u mundësuar Operatorëve Ekonomikë të rishikojnë konfigurimet e produkteve, të kërkojnë oferta të reja nga prodhuesit apo distributorët, të rillogarisin çmimet dhe të përgatisin ofertat në përputhje me kërkesën e ndryshuar.

4. Shkelja e nenit 53, paragrafi 7, të LPP-së

Kjo çështje është veçanërisht e rëndësishme duke pasur parasysh se vetë Autoriteti Kontraktues, në Vendimin për Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, deklaron se:

“AK me kohe ka sqaruese specifikat teknike dhe ka njoftuar te gjithë OE pjesëmarrës mbi ndryshimin e specifikave teknike.”

Pra, vetë Autoriteti Kontraktues e karakterizon veprimin e tij si **sqarim të specifikimeve teknike**.

Megjithatë, nëse bëhet fjalë për informacion sqarues apo plotësues të dhënë më pak se 10 ditë para afatit të fundit për dorëzimin e ofertave, atëherë gjen zbatim **neni 53, paragrafi 7, i LPP-së**, sipas të cilit afati duhet të zgjatet në mënyrë që Operatorët Ekonomikë të kenë të paktën **10 ditë nga data e dhënies së informacionit relevant** për të dorëzuar ofertat.

Në rastin konkret, ndryshimi nga **512 GB në 1 TB** është komunikuar më **07.08.2026**, ndërsa afati për dorëzimin e ofertave nuk është zgjatuar në mënyrë që Operatorëve Ekonomikë t'u sigurohej periudha minimale e përcaktuar me ligj.

Për më tepër, **neni 53, paragrafi 9**, parasheh se kur para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave bëhet e nevojshme dhënia e informatave sqaruese ose plotësuese, Autoriteti Kontraktues duhet t'ua sigurojë ato me shkrim të gjithë Operatorëve Ekonomikë relevantë dhe të zgjasë afatin në përputhje me dispozitat përkatëse të nenit 53.

Prandaj, konsiderojmë se **njoftimi i Operatorëve Ekonomikë, në vetvete, nuk e zëvendëson detyrimin ligjor për zgjatjen e afatit**, kur plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin 53, paragrafi 7, të LPP-së.

Për më tepër Autoriteti Kontraktues, nuk ka ndryshuar as dokumentet, sic është Lista e përshkrimeve të cmimeve LOT 4, ku akoma figuron memoria e diskut min 512GB, dhe as që është publikuar Formulari për korrigjim të gabimeve, me të cilin OE njoftohen për ndryshimet e bëra nga AK në kërkesat e tyre.

5. Përgjigje ndaj arsyetimit të Autoritetit Kontraktues

Në vendimin e tij, Autoriteti Kontraktues arsyeton se oferta jonë për LOT 4 nuk i plotëson kërkesat teknike, pasi kemi ofertuar kapacitet prej **512 GB**, ndërsa kërkesa aktuale është **minimum 1 TB**.

Ne **nuk pretendojmë se 512 GB është e barabartë me 1 TB** dhe nuk kërkojmë që oferta jonë të konsiderohet në përputhje me një kërkesë teknike të ndryshme.

Pretendimi ynë është tjetër.

Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues nuk ka pasur të drejtë të na eliminojë mbi bazën e kërkesës së ndryshuar nga 512 GB në 1 TB, pa respektuar paraprakisht detyrimet ligjore lidhur me mënyrën dhe kohën e komunikimit të ndryshimit dhe, në veçanti, detyrimin për zgjatjen e afatit të ofertimit kur informacioni relevant është dhënë më pak se 10 ditë para afatit përfundimtar.

Nëse ndryshimi nga 512 GB në 1 TB konsiderohet nga Autoriteti Kontraktues si “**sqarim**”, atëherë duhet të zbatohet neni 53, paragrafi 7, i LPP-së.

Nëse, nga ana tjetër, Autoriteti Kontraktues pretendon se nuk bëhet fjalë për sqarim, por për **ndryshim të specifikimit teknik**, atëherë duhet të vlerësohet nëse ky ndryshim është bërë dhe komunikuar në përputhje me kërkesat e LPP-së dhe nëse Operatorëve Ekonomikë u është dhënë kohë e mjaftueshme për të përshtatur ofertat e tyre.

Në të dyja rastet, konsiderojmë se nuk mund të ngarkohemi me pasojën e një kërkesë të re teknike, kur ajo kërkesë është vendosur vetëm në një fazë shumë të vonshme të procedurës dhe pa na dhënë një mundësi reale për të rishikuar dhe përshtatur ofertën tonë.

6. Shkelja e parimit të trajtimit të barabartë dhe transparencës – neni 7 i LPP-së

Në pajtim me **nenin 7 të LPP-së**, Autoriteti Kontraktues duhet t'i trajtojë Operatorët Ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe duhet të veprojë në mënyrë transparente.

Ne konsiderojmë se zbatimi i një kërkesë të ndryshuar teknike ndaj ofertave të dorëzuara, pa siguruar një periudhë të mjaftueshme për të gjithë Operatorët Ekonomikë që të përshtatin ofertat e tyre, cenon parimin e trajtimit të barabartë.

Gjithashtu, një situatë e tillë ndikon në konkurrencën efektive, pasi Operatorët Ekonomikë të cilët e kanë përgatitur ofertën sipas specifikimit fillestar prej **512 GB** nuk kanë pasur të njëjtat kushte kohore dhe praktike për të kaluar në konfigurimin prej **1 TB**.

Për këtë arsye, konsiderojmë se çështja nuk duhet të vlerësohet vetëm nëse oferta jonë teknike përfundimisht përmbush apo jo kërkesën prej 1 TB, por duhet të vlerësohet **më parë ligjshmëria e mënyrës se si kjo kërkesë është ndryshuar dhe është bërë e zbatueshme për Operatorët Ekonomikë.**

7. Shkelja nuk mund të korrigjohet – kërkesa për anulimin e LOT 4

Konsiderojmë se shkelja e evidentuar në këtë procedurë nuk është një parregullsi formale e cila mund të korrigjohet përmes një rivlerësimi të ofertave.

Shkelja ka ndodhur **gjatë vetë zhvillimit të procedurës së prokurimit**, përkatësisht në mënyrën dhe kohën e ndryshimit të një kërkesë materiale teknike për LOT 4, nga minimum **512 GB në minimum 1 TB**, si dhe në mosdhënien e kohës së mjaftueshme për Operatorët Ekonomikë për të përshtatur ofertat e tyre ndaj kërkesës së ndryshuar.

Si rezultat i kësaj shkeljeje, ne jemi vlerësuar dhe eliminuar mbi bazën e një kërkesë teknike të ndryshuar në një fazë të vonshme të procedurës.

Konsiderojmë se kjo situatë nuk mund të korrigjohet në mënyrë të ligjshme vetëm përmes rivlerësimit të ofertës sonë, pasi problemi nuk qëndron vetëm në rezultatin e vlerësimit teknik, por në **ligjshmërinë e vetë procedurës dhe të kushteve mbi bazën e të cilave Operatorët Ekonomikë kanë përgatitur dhe dorëzuar ofertat**.

Në këtë drejtim, i referohemi **nenit 62, paragrafi 1.1, të LPP-së**, sipas të cilit aktiviteti i prokurimit duhet të përfundohet kur një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë gjatë procedurës dhe shkelja nuk mund të rregullohet apo parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit.

Në rastin konkret, konsiderojmë se pikërisht kjo situatë është krijuar, pasi një ndryshim i mëvonshëm i specifikimit teknik, pas përgatitjes së ofertave dhe pas kalimit të afatit të ofertimit, nuk mund ta rikthejë situatën në gjendjen e konkurrencës së barabartë që do të ekzistonte sikur të gjithë Operatorët Ekonomikë të kishin pasur mundësi të barabarta për të përgatitur ofertat në bazë të kërkesës përfundimtare.

Për më tepër, **nuk do të ishte e mjaftueshme që vetëm oferta jonë të rivlerësohet**, pasi një masë e tillë nuk do ta korrigjonte shkeljen e krijuar gjatë fazës së përgatitjes dhe dorëzimit të ofertave dhe nuk do ta eliminonte pasojën e ndryshimit të vonshëm të specifikimit teknik.

Rrjedhimisht, konsiderojmë se **masa e nevojshme dhe efektive për rikthimin e ligjshmërisë në këtë procedurë është anulimi i LOT 4 në tërësi**.

Nëse Autoriteti Kontraktues e konsideron ende të nevojshëm realizimin e prokurimit të këtij objekti, procedura duhet të zhvillohet përsëri, me kërkesa dhe specifikime të qarta, të përcaktuara dhe të publikuara në përputhje me LPP-në, duke u siguruar të gjithë Operatorëve Ekonomikë mundësi të barabarta për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertave.

KËRKESA PËRFUNDIMTARE

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe argumentet e paraqitura më sipër, **ne kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që:**

1. **Ta aprovojë ankesën tonë si të bazuar;**
2. Të konstatojë se gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit për **LOT 4** janë shkelur dispozitat e LPP-së, përfshirë **nenet 7, 27, 28, 44 dhe 53**, lidhur me ndryshimin e specifikimit teknik nga minimum 512 GB në minimum 1 TB dhe mosdhënien e kohës së mjaftueshme për Operatorët Ekonomikë për përshtatjen e ofertave;
3. Të konstatojë se ndryshimi i specifikimit teknik ka qenë ndryshim material që ka ndikuar në kushtet e konkurrimit dhe në përgatitjen e ofertave të Operatorëve Ekonomikë;

4. Të konstatojë se Autoriteti Kontraktues, pavarësisht se e ka cilësuar ndryshimin si “sqarim”, nuk ka respektuar detyrimet ligjore lidhur me zgjatjen e afatit të ofertimit, në pajtim me **nenin 53 të LPP-së**;
5. Të konstatojë se shkelja e evidentuar ka ndikuar drejtpërdrejt në procedurën e konkurrimit dhe në vlerësimin e ofertës sonë;
6. Të konstatojë se shkelja nuk mund të korrigjohet në mënyrë efektive përmes një rivlerësimi të ofertave apo përmes ndryshimit të vendimit të Autoritetit Kontraktues;
7. **TË ANULOJË NË TËRËSI LOT 4** të këtij aktiviteti të prokurimit, në pajtim me **nenin 62, paragrafi 1.1, të LPP-së**;
8. Si pasojë e anulimit të LOT 4, të anulojë çdo vendim të Autoritetit Kontraktues të nxjerrë në kuadër të këtij LOT-i, përfshirë **Vendimin e datës 09.09.2026 për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim**, në pjesën që lidhet me LOT 4;
9. Nëse Autoriteti Kontraktues e konsideron ende të nevojshëm realizimin e prokurimit për objektin e LOT 4, të zhvillojë **një procedurë të re të prokurimit**, në përputhje me dispozitat e LPP-së dhe duke garantuar trajtim të barabartë, transparencë dhe konkurrencë efektive për të gjithë Operatorët Ekonomikë.

Në përfundim, theksojmë se **nuk kontestojmë faktin teknik se 512 GB dhe 1 TB janë kapacitete të ndryshme**, dhe as nuk kërkojmë që oferta jonë prej 512 GB të konsiderohet e barasvlershme me kërkesën prej 1 TB.

Ajo që kontestojmë është mënyra dhe koha në të cilën Autoriteti Kontraktues ka ndryshuar një kërkesë materiale të tenderit, si dhe fakti se kjo kërkesë e ndryshuar është përdorur më pas si bazë për eliminimin e ofertës sonë, pa u siguruar Operatorëve Ekonomikë koha dhe mundësia e nevojshme për të përshtatur ofertat e tyre.

Për këtë arsye, konsiderojmë se shkelja ka prekur vetë kushtet dhe procesin e konkurrimit dhe, si e tillë, nuk mund të korrigjohet vetëm në fazën e vlerësimit të ofertave. **Prandaj, kërkojmë që LOT 4 të anulohet në tërësi.**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet e shkaktuara me rastin e përgatitjes së Kërkesës për Ri-shqyrtim te Autoriteti Kontraktues dhe Ankesës në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

1. Ftesa për ofertim
2. Sqarimet e publikuara nga Autoriteti Kontraktues, datë 07.08.2026
3. Kërkesa për Rishqyrtim dërguar AK përmes Platformës së e-Prokurimit, 07.09.2026
4. Vendimi i Autoritetit Kontraktues mbi refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, 09.09.2026
5. Dëshmia Pagesa e Ankesës ne OSHP

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.